

Në bazë të dispozitave të nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshim dhe Plotësim të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe nenit 34 paragrafi 4 të Statutit të Ndërmarrjes si dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2024 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Komisioni i auditimit i NPL "EKO-SIG" SH.A., në mbledhjen e mbajtur me datë 26.05.2025 shpall:

KONKURS PËR VENDE PUNE

Për pozitën :

Auditor/e i/e Brendshëm

Vendi: Pejë

Ndërmarrja: Ndërmarrja Publike Lokale "EKO-SIG" SH.A. Pejë

I përgjigjët: Komisionit të Auditimit

Kompensimi: Kompensimi bëhet në bazë të deklaratës mbi politikën e kompensimit të ndërmarrjes

Kohëzgjatja: për kohë të caktuar 3 vite, me mundësi vazhdimi

Orari i punës: I plotë.

Kualifikimi dhe përgatitja profesionale

Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, si dhe plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l), nenit 17.3 pika (a), dhe (b), detyrimit të dhënies së deklaratës nën betim sipas nenit 17.5 të Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe plotësim ndryshimit të ligjit për ndërmarrjet publike nr. 04/L-111 neni 13 dhe se kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë. Përveç këtyre kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Diplomë universitare në ekonomi, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo juridik.
- Preferohet certifikim profesional (SCAAK, IKAF, ose ekuivalent).
- Së paku tre (3) vite përvojë pune relevante, përfshirë auditimin e brendshëm ose të jashtëm, analizë financiare ose pozita të ngjashme.
- Njohuri të mira të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.
- Aftësi të larta analitike dhe raportuese, integritet profesional dhe pavarësi në vendimmarrje.

-
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit
 - Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
 - Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
 - Aftësi shumë të mira të komunikimit verbal dhe me shkrim në gjuhën shqipe; njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

Zyrtari për Auditim të Brendshëm ka këto kompetenca:

- Udhëheqë dhe organizon auditimin e brendshëm, në përputhje me rregullat dhe standardet për auditim të brendshme në fuqi.
- Zbaton të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Kryen detyrat e përcaktuar nga Komisioni i Auditimit, dhe
- Ka pavarësi funksionale për të planifikuar, kryer dhe raportuar për aktivitetet e auditimit të brendshëm dhe nuk kryen detyra të tjera në kuadër të ndërmarrjes që nuk lidhen me funksionin e auditimit të brendshëm.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja që konkurrojnë për pozitat e lartcekura duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin i cili merret në zyret e ndërmarrjes NPL "Eko-Sig" SH.A ish objekti i QMF Karagaç Pejë ;
- CV-në;
- Dëshminë e shkollimit kopje të noterizuar. Diplomat nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI;
- Dëshminë për përvojën e punës (Trusti pensional);
- Referenca si dhe certifikatat tjera profesionale;
- Letër motivimin;
- Deklaratën nën betim (merret nënshkruhet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj);
- Kopjen e Letërnjoftimit.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga data: 26.05.2025 – 09.06.2025, ora 16:00. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Aplikacionet me dokumentet përcjellese, dorëzohen dhe pranohen të kompletuara në pliko (zarf) NPL "Eko-Sig" SH.A me adrese në ish-objekti i QMF "Karagaç" në Pejë.

Per info shtesë mund të kontaktoni sekretarinë e ndërmarrjes në nr të tel.049-199-320 ose në e-mail adresën nplekosig@gmail.com. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe e-mail adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.